



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA**

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2019

Njoftim

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; te ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë.16.07.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 12.12.2019, ora 09:00** në sallën e Mbledhjeve të ERE-s do të zhvillohet mbledhja e radhës e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga FMF për muajin Nëntor 2019 (Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve)
- 2-** Mbi shqyrtimin e kërkesës së OST sh.a për përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2020 (Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve)
- 3-** Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s, nr. 268/2018 dhe vendimit nr. 8/2019 (Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve)
- 4-** Mbi miratimin e rregullave për monitorimin e tregut të energjisë elektrike (Drejtoria e Monitorimit të Tregut)
- 5-** Mbi kërkesën e KESH dhe OSHEE për rishikimin e vendimit nr. 167, dt. 04.11.2019 “Mbi miratimin e draft kontratës për shit-blerjen e energjisë elektrike (Drejtoria e Çështjeve Ligjore)
- 6-** Mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Draft rregullores së profileve të standardizuara të ngarkesës” (Drejtoritë ERE)
- 7-** Mbi shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2019 dhe atë të përditësuar 10-vjeçar 2015-2025, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST (Drejtoritë ERE)
- 8-** Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Energia Gas and Power Albania”, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes)
- 9-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Wenerg” për barrësim të aseteve të luajtshme, në favor të “OTP Albania” (Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes)

10- Informacion në lidhje me kërkesën e shoqërisë “Wonder” sh.p.k për trajtimin e konfidencialitetit, lidhur me dokumentacionin e depozituar në dosjen e Wonder sh.p.k (Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes; Drejtoria e Çështjeve Ligjore)

KRYETARI
Petrit AHMETI

Në Mungesë dhe me Autorizim

Anëtare e Bordit
Erjola SADUSHI